REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr8552 prot. Tiranë, më 22.10.2026

U R D H Ë R

Nr223, datë22.10.2026

PËR

EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMITETIT KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr.9000, datë 30.01.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të pikës 1.3, të vendimit nr.406, datë 19.06.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për strukturat e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM)",

U R DH Ë R O J:

1. Emërimin e anëtarëve të Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM), i cili kryesohet nga Z. Ardian Islami, emëruar me urdhrin e Kryeministrit, nr.141, datë 1.9.2026 dhe në përbërje të tij të ketë këta anëtarë, përfaqësues të institucioneve të mëposhtme:

a) Z. Ermal Kacurri Anëtar Përfaqësues nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare;
b) Z. Andi Spahiu Anëtar Përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
c) Z. Andi Vila Anëtar Përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
ç) Z. Tomi Decolli Anëtar Përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
d) Znj. Adisa Bala Anëtar Përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes;
dh)Znj. Shpresa Gashi Anëtar Përfaqësues nga Universiteti Politeknik;
e) Z. Klodian Zaimi Anëtar Përfaqësues nga Instituti i Gjeoshkencave;
ë) Z. Neritan Aleksi Anëtar Përfaqësues i propozuar nga Kryetari i KKDM.

2. Detyrën e sekretarit të KKDM-së e kryen Znj. Rolanda Hila, sekretar i Sekretariatit Kombëtar të Digave të Mëdha (SKDM), pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për çdo anëtar, bëhet sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, pëe përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore.

4. Për zbatimin e detyrave që rrjedhin nga ky urdhër, si dhe për funksionimin e Këshillit Teknik të Përhershëm të Digave të Mëdha, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ngarkohen

Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

5. Urdhri nr. 260, datë 09.09.2020, i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, "Për përbërjen e anëtarëve të Këshillit Teknik të Përhershëm të Digave të Mëdha", shfuqizohet.

6. Ngarkohen anëtarët e KKDM për zbatimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Enea Karakaçi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
TIRANË